


10. Stërvitja e skuadrës



Kjo është skuadra e futbollit “Zemërluanët”. Genti është trajner i skuadrës. Ai i do shumë fëmijët dhe i quan ata “engjëjt e mi”. Genti është trajner i dashur dhe i kujdesshëm. Fëmijët e duan dhe e respektojnë Gentin. Skuadra stërvitet tri ditë në javë. Sot Tomi ndjek stërvitjen dhe gëzohet për Gentin.

Fëmijët po përgatiten për ndeshjen miqësore me skuadrën shkollore “Pëllumbat e Paqes”.

Të dyja skuadrat janë të mira. Futbollistët 11 vjeçare janë të shpejtë dhe të zotë. Ata e adhurojnë sportin. Ndeshja zhvillohet të dielën më 1 qershor në Tiranë.

Fëmijët janë shumë entuziastë dhe të motivuar. Ata premtojnë një lojë tërheqëse. Kush fiton?

Të dyja skuadrat premtojnë fitoren.

- “Ne e fitojmë lojën! Ne jemi më të fuqishëm!”
- “Ne e fitojmë lojën! Ne jemi më të mirët!”

Merken Sie sich: Zusammengesetzte Wörter in der bestimmten Form werden ins Albanische mit Genitiv übersetzt:

die Fußballmannschaft – **skuadra e futbollit**

die Schultasche – **çanta e shkollës**

der Rucksack – **çanta e shpinës**

→ Gr. S. 69

Ü. 13–19

Der Genitiv bei Substantiven mit Gelenkartikel:

Substantiv (weiblich) – Gelenkartikel **e**

skuadra e futbollit

Substantiv (männlich) – Gelenkartikel **i**

trajneri i skuadrës

Substantiv (Plural m. + f.) – Gelenkartikel **e**

çantat e fëmijëve

11. **Audio 5** Dëgjoni audion. Punoni me fjalor dhe përktheni fjalët.

ko-	rë	_____
qa-	qe	_____
bu-	jë	_____
do-	kë	_____
shpi-	fë	_____
go-	tull	_____
flo-	llë	_____
ve-	në	_____
hu-	kë	_____
ba-	shë	_____
ve-	zë	_____
fa-	ndë	_____

12. **Audio 6** Dëgjoni audion. Punoni me fjalor dhe përktheni fjalët.

→ Gr. S. 72

zemër	shqiponjë	zemërluan
sy	luan	_____
gojë	derr	_____
duar	artë	_____
kokë	shkabë	_____
hundë	mjaltë	_____

13. Shkruani sinonimet përbri.

trim	=	_____ zemërluan _____
punëtor	=	_____
i, e dashur	=	_____
kokëfortë	=	_____

Ü. 20–22

	Die Langform der Personalpronomen	
Personalpronomen, Nominativ	Personalpronomen, Dativ	Kurzform, Dativ
unë - ich	mua	më → mir
ti - du	ty	të → dir
ai - er	atij	i → ihm
ajo - sie	asaj	i → ihr

→ Gr. S. 71

Merken Sie sich:

Hier fällt auf, dass mit Ausnahme von *i* (ihm/ihr) und *u* (ihnen) die Kurzformen im Dativ mit denen im Akkusativ identisch sind.

14. Beni është i sëmurë.

- Mirëdita!
- Mirëdita! Urdhëroni!
- Unë kam dhimbje në bark. Më dhemb edhe këtu, djathtas.
- Uluni, ju lutem. Që kur keni dhimbje?
- Që sot në mëngjes. Dhimbjet janë të forta, por jo të vazhdueshme.
- A ju dhemb këtu?
- Po!
- Po ju jap një recetë. Ilaçin duhet ta pini dy herë në ditë.
- Por punën nuk duhet ta lë, apo jo? A mund të rri disa ditë pushim?
- Jo, punën mund ta vazhdoni, por duhet të jeni i kujdesshëm.
- Hm, mirë.
- Mjeku i shkruan pacientit një recetë dhe i jep atij një këshillë.
- Faleminderit, ditën e mirë!
- Ju lutem! Ditën e mirë!

Ü. 23

15. Audio 7 Ela kërkon një dentist të aftë.

Ü. 24-31

- Çfarë ke? Të dhemb dhëmbi?
- Po, më dhemb dhëmballa. Duhet të shkoj te dentisti. A njih një dentist të aftë?
- Po, dentistja ime, zonja Kinkaj, e ka klinikën në rrugën "Nënë Tereza". Ta rekomandoj atë. Ajo është e saktë dhe e kujdesshme. Këtu kam kartëvizitën e saj.
- Faleminderit! Edhe Mira ka nevojë për një vizitë dentare. Po i tregoj edhe asaj për këtë dentiste.

Die Langform der Personalpronomen, Singular			
Personalpronomen, Nominativ, Singular	Personalpronomen,	Kurzform,	
	Dativ	Dativ	
ne - wir	neve	na	→ uns
ju - ihr, Sie	juve	ju	→ euch/Ihnen
ata - sie	atyre	u	→ ihnen
ato - sie	atyre	u	→ ihnen

→ Gr. S. 71

Merken Sie sich:

Hier fällt auf, dass mit Ausnahme von *i* (ihm/ihr) und *u* (ihnen) die Kurzformen im Dativ mit denen im Akkusativ identisch sind.

16. Këshillat e Klarës.

Xhejmsi: Na dhembin të gjithë muskujt nga sporti.

Klara: Po! Tomit dhe Karlosit gjithashtu. Edhe atyre u them shpesh që sporti duhet të bëhet rregullisht.

Karlosi: Po, ke të drejtë, por ne nuk kemi kohë.

Klara: Po, po. Justifikime!



Tomi: Klara na jep gjithmonë këshilla për sportin.

Klara: Po, ashtu është. Kështu shpesh bëhem edhe e mërzitshme.

Tomi, Karlosi, Xhejmsi: Jo! Ti je Klara jonë e dashur!

Ü. 32–37